



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/31
Datë: 31.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 16, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2026.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi, ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 45 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/31
Datë: 31.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 10/001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 21,000.00€ (njëzetënjë mijë eurosh), për realizimin e shfaqjes "Iaverna Mirësia - Mario, Bella, Anastasia", me regji të Mario Banushit.
2. Mbështetja financiare e shfaqjes nga pika 1. e këtij Vendimi, i shërben promovimit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare përmes diplomacisë kulturore, duke fuqizuar imazhin e vendit si shtet që mbështet krijimtarinë artistike bashkëkohore, nxit bashkëpunimin me emra të njohur të skenës evropiane dhe kontribuon në rritjen e profilit kulturor e ndërkombëtar të Kosovës.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami "Programi për Promovim të Vendit" dhe barten në xhirollogarinë e organizatës "Toofareast P.C".
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/31
Datë: 31.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241, të datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,400,000.00€ (një milion e katërqind mijë eurosh), për zbatimin e Masës 3.8 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e Masës 3.8.
3. Mjetet, sipas këtij Vendimi, transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/31

Datë: 31.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241, të datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2026, merr këtë:


V E N D I M

1. Ndryshohet pika 2.2. e Vendimit të Qeverisë Nr. 08/20, të datës 22.05.2026, dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

2.2. Për pikën 1.3. të këtij Vendimi ndahen 23,600,000€ (njëzetetë milionë e gjashtëqind mijë euro).
2. Mjetet e lira buxhetore prej 1,400,000€ (një milion e katërqind mijë euro) që rezultojnë të lira nga ndryshimi dhe plotësimi sipas pikës 2.2. të këtij Vendimi, shfuqizohen dhe konsiderohen si të paalokuara dhe të pashpenzuara, si dhe mbeten pjesë e ndarjes buxhetore fillestare.
3. Pjesët e mbetura të Vendimit të Qeverisë Nr. 08/20, të datës 22.05.2026, mbeten të pandryshuara dhe të paafektuara nga ky Vendim.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë